

VENDIM
Nr. 59, datë 29.1.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 428, DATË 19.7.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘RIKONSTRUKSION I RRUGËS EKZISTUESE VLORË–ORIKUM DHE I DY BY-PASS-EVE NË RADHIMË, VLORË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 428, datë 19.7.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rikonstruksion i rrugës ekzistuese Vlorë-Orikum dhe i dy *by-pass*-eve në Radhimë, Vlorë”, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikat 3 dhe 4, vlera “... 202 682 342.35 (dyqind e dy milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e dyzet e dy pikë tridhjetë e pesë) lekë ...” zëvendësohet me “... 239 563 573.93 (dyqind e tridhjetë e nëntë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e tre) lekë ...”;

b) Tabelës, bashkëlidhur vendimit, i shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Vlorë.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT, “PËR SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 428, DATË 19.7.2023, PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT ‘RIKONSTRUKSION I RRUGËS EKZISTUESE VLORË–ORIKUM DHE I DY *BY-PASS*-EVE NË RADHIMË VLORË”

Nr. rendor	Zona	TË DHËNAT E PRONARIT	TË DHËNAT KADASTRALE				TË DHËNAT E SHPRONËSIMIT				ADRESA		SHËNIME
		Emër / Aftësi / Mbiemër	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja totale e parcelës (m ²)	Zëri kadastral	Sipërfaqja shpronësim (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera totale e tokës në lekë	Vlera totale	Bashkia	Fshati	
26	Bp-2	Aida Alim Dushku	3140	160/8/4	35049	anë	3,186	11,576.03	36,881,231.58	36,881,231.58	Vlorë	Radhimë	Konfirmuar nga ASHK-ja
VLERA TOTALE									36,881,231.58	36,881,231.58			